



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 54/2012
Prishtinë, më 12.03. 2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani, dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të ftuar: Ahmet Krasniqi- u.d. i kryetarit të Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës; Halit Shabani dhe Gani Asllani- anëtarë të Bordit të AKK-së.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZRPK; dhe Florije Mehmeti- KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.03.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2011;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - Propozoi që pika e dytë e rendit të ditës-Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.03.2012, të shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse mungon procesverbali në gjuhën serbe.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2011. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës (AKK), z. Ahmet Krasniqi, i cili do të paraqesë një ekspozë të shkurtër për këtë Raport në Komision dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Ahmet Krasniqi (Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës - AKK) – Sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, në nenin 28, pika 1 shkronja 12, na obligon që para Kuvendit të paraqesim raportin vjetor, deri më 31 mars. Më duhet pak një historik i shkurtër që të tregoj për Komisionin e Konkurrencës, i cili në fillim është emëruar nga Kuvendi, pra një komision prej 5 anëtarësh, në kushte çfarë ju i dini mirë dhe gjithherë i kemi paraqitur si problem kushtet që jemi duke punuar. Jeni të njohur se brenda një kohë të shkurtër kemi bërë një staf të vogël, por në mungesë të hapësirave që kanë qenë jemi detyruar që ta shtyjme pranimin e zyrtarëve që i kemi pasur të nevojshëm. Kështu, gjatë vitit 2011 na ka përcjellë i njëjti problem, pa staf profesional. Është dashur që ne si Komision të merremi edhe me punë profesionale, meqenëse ligji paraprak nuk na ka ndaluar të dalim edhe në hetime, kontrole, sepse është detyrë e stafit që të dalë dhe të hulumtojë dhe t'i monitorojë tregjet në Kosovë. Gjatë vitit 2011, më tepër jemi me bankat, sepse kemi një opinion në publik se në banka janë kamatat e larta, kështu që jemi marrë me këtë çështje dhe kemi bërë disa analiza. Ne kemi bërë një analize të mirëfilltë, që është pranuar prej opinionit dhe prej komisionit dhe prej të gjithë atyre që u kemi raportuar në mënyrë profesionale. Gjithashtu me pozitën dominuese edhe aty duhet të kemi bazë të fortë për marrjen e një vendimi, kështu që duhet një kontroll apo një monitorim pak më i thellë. Ne i kemi marrë disa vendime, por në vitin 2011 nuk kemi marrë ndonjë vendim që e kemi gjobitur dikë apo e kemi shqyrtuar ndonjë masë. Ne kemi marrë një vendim për pompat e benzinës në rajonin e Vushtrisë, por nuk i kemi dënuar për arsye se shihet qartë se ata nuk kanë qenë të njohur me konkurrencë, ata mendonin që shkelet konkurrenca, nëse e ngrit apo e zbrit çmimin, kurse qëllimi ynë është që konkurrenca të caktohet në bazë të çmimeve dhe të cilësisë së produktit. Ne iu kemi dhënë një vërejtje. Gjithashtu, kemi pasur edhe disa kontrole teknike, i kemi bërë një rekomandim Ministrisë së Infrastrukturës që kontrollet teknike të mos kufizohen në një komunë, sepse ajo është ndarje e tregut dhe faktikisht është në kundërshtim me Ligjin e konkurrencës dhe faktikisht kemi hasur në mirëkuptim me Ministrinë përkatëse dhe është përfunduar ajo punë.

Kryetari - Parashitro disa pyetje: Çka për ju si Autoritet i Konkurrencës është sfidë: tregu i derivateve të naftës, bankat, kompanitë e sigurimeve apo institucionet tjera? Te cili komunitet e parashihni më shumë sfidën dhe te cili është tregu më normal ose që e respektojnë bizneset? Gjatë punës tuaj, çka keni vërejtur në këtë drejtim? Dhe çështja tjetër që më intereson është po ashtu edhe konsolidimi edhe çështjet tjera, por ju keni përmendur po ashtu përkrahjen e pamjaftueshme dhe ruajtjen e pavarësisë së Autoritetit, dëshiroj ta di dhe ta konkretizoni, çka

sipas jush është problem në pavarësimin tuaj, çka përfshihet, çka mendoni me pavarësi institucionale të Autoritetit?

Berat Buzhala – Te vendimi që është marrë prej Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që të refuzohet kërkesa e shoqatës së kompanive të sigurimeve, a po respektohet ky vendim i juaj për këtë apo edhe më tutje është ajo gjendje që ka qenë më parë, që kompanitë e sigurimeve realisht veprojnë në mënyrë të kundërligjshme? Pra, a janë marrëveshje monopoliste me njëra-tjetrën? Pyetja e dytë, nuk di a është në domenin e juaj, është një lloj i biznesit që është shumë specifik, edhe që për mendimin tim kanë krijuar monopol, është fjala për licencat nacionale të televizioneve publike, janë tri televizione publike me frekuenca nacionale që sot e kësaj dite prej vitit 2000 nuk lejojnë të hyjë edhe i katërti brenda atij sistemi, edhe kjo për mendimin tim ka ndikuar që tregu i medias në Kosovë të jetë i fundit në Ballkan për nga cilësia dhe për nga raportimet. A mund të ndikoni që të bëhet presion që të liberalizohet tregu? Unë e kuptoj që nuk mund të jepen 100 licenca, por së paku të hapet mundësia që, nëse mediat e caktuara nuk janë në kuadër të frekuencave nacionale dhe nuk i kanë plotësuar kushtet, pse dikujt t'i refuzohet e dikujt t'i jepet licenca, është e pamundshme për mendimin tim sot e 12 vjet që të kemi të njëjtat televizione e të mos krijohet diçka tjetër, edhe përkundër iniciativave që ka pasur, qoftë prej bizneseve private apo tjerëve që kanë pasur dëshirë që të marrin iniciativa të tilla.

Myzejene Selmani - Duke marrë parasysh që në bazë të Kushtetutës dhe në bazë të Ligjit mbi konkurrencën, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i obliguar që në muajin mars të raportojë para komisionit parlamentar dhe brenda Kuvendit, për arsye se i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe duke e ditur çfarë është raporti i dytë, i cili është sjellë në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, prapëseprapë mbetet që në të ardhmen, ndoshta vitin tjetër, të vijë një raport edhe më i mirë, për arsye se Autoriteti i Konkurrencës është autoritet i pavarur me të gjitha udhëzimet administrative, të cilat duhet të nxirren nga Ligji i konkurrencës, pra që mund të nxirren nga ju dhe Ministria e Tregtisë dhe kisha kërkuar që ndoshta edhe në këtë aspekt, ju të jeni kryesorët që të nxirrni këto udhëzime administrative dhe këtë si e hierarkisë së zhvillimit ekonomik dhe në bazë të tregut të lirë, të cilin e jep edhe Kushtetuta. Z. Ahmeti, ju jeni ata të cilët duhet të shikoni tregun se kah po shkon. Ju keni dhënë disa opinione tuajat për mbikëqyrjen e bankave, të arkave fiskale, të derivateve të naftës. Mirëpo, për heqjen e monopolit ekonomik, i cili ekziston në Kosovë, më duket që është një staf shumë i vogël brenda Komisionit të Konkurrencës, dhe ju duhet të keni një staf shumë të madhe për arsye të rëndësisë shumë të madhe dhe decentralizimit të ekonomisë së Kosovës. Shpresoj që raporti tjetër i ardhshëm i juaj të vijë me kompletim të Bordit dhe me kompletim të kompetencave çfarë ua jep Ligji i konkurrencës.

Ramiz Kelmendi – Është e vërtetë që ka pasur një shpërndarje shumë mistike dhe ka qenë në kundërshtim me Ligjin e konkurrencës. Unë mendoj që, ju si Komision i shpërndarë, duhet të merrni edhe ministrinë ose të kryeni një proces që kjo të vazhdojë të jetë edhe ndaj elementeve të tjerë të kontrolleve teknike, siç është QAK-u, pse të jete vetëm një QAK-u, a është konform ligjit ky monopolizim i kontrollit gjeneral të një automjeti të koduar? Të punohet edhe rreth çështjes së pompave të benzinës, të shihet pse është çmimi kaq unik, pse nuk ka konkurrence, mos ekziston ndonjë marrëveshje e fshehtë apo diçka e tillë. Ka mbetur pa përfunduar edhe çështja e arkave fiskale, a është duke u trashur monopoli, a janë duke u kyçur më shumë aktorë të fiskalizimit?

Hashim Deshishku - Para se të shtroi pyetjet, tha se ka vërejtje në Raport. Vërejtja e parë është në faqen 8 të raportit të AKK-së ku thotë, citoj: "problem në vete paraqet edhe vetë të kuptuarit e punës së konkurrencës". Nëse AKK-ja nuk e kupton punën e vet, atëherë kush ta kuptojë këtë lëmi dhe kush t'i kontrollojë edhe institucionet tjera. Vërejtja e dytë në Raport është të kompanitë e sigurimeve, po më intereson a është i sqaruar ende Ligji i Bankës Qendrore? Me cilin ligj duhet të punojë kompania? A duhet të punojë me rregullat e juaja apo me të Bankës

Qendrore? Tjetrën vërejtje e kam te arkat fiskale, nuk e di a e dini, kompanitë të cilat shesin arka fiskale vetëm një arkë fiskale e kanë, si kompania e madhe, si ai që e ka një kioskë duhet ta blejnë të njëjtë, nuk kanë dallime ato. Ekzistojnë arka fiskale me numër të kuponëve deri në 3000 apo deri në 30000, nuk e di krejt saktë. Janë të obliguar si një kafene, si një kompani e madhe të blejnë çmimin e njëjtë të arkës fiskale, duhet t'i shikoni shtesat e arkës fiskale që të kenë edhe modele të tjera me kapacitete të ndryshme. Kurse te bankat, a keni ndonjë krahasim me vendet e rajonit për kamata dhe depozita, këtu duhet të bëhet edhe një krahasim me vendet e rajonit, si: Maqedonia, Shqipëria etj. duhet të bëhet një krahasim sa janë më të mëdha apo sa janë atje. Kurse sa i përket raportit financiar, në faqen 33, thoni: “veprimtaritë ekonomike financiare”, çfarë veprimtarie kryen agjencia e konkurrencës, këtu i ka shpenzimet, harxhimet dhe të gjitha, do të ndryshojë ky titull apo nëntitull? E keni te shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit dhe shpenzimet e tjera jashtë vendit, këto të dyja duhet të sqarohen në shpenzimet jashtë vendit 24.892, kurse nën dy, i keni shpenzimet e tjera jashtë vendit d.m.th. vetëm bileta iu kanë shkruar 10.000 euro. Pastaj për akomodim 21.400, çka do të thotë kjo? Dhe në fund, kisha kërkuar nga AKK-ja që me të vërtetë, megjithë punën që e bëni, këtë ta bëni edhe në sektorin e energjisë.

Teuta Sahatqia – A ka mundësi të tregoni se çka keni vërejtur në sektorin bankar, a ka aty marrëveshje, sepse të gjithë e dimë se janë kamatat e larta, janë kushtet e vështira, cili ka qenë ai përfundimi që keni arritur ju në sektorin bankar?

Lutfi Zharku – Në lidhje me monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, thuhet se Ligji për konkurrencën duhet ndryshuar për përafrim sa më të mirë në atë pikë. A ka një raport nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, cilat janë elementet që duhet ndryshuar?

Sala Berisha- Shala - Theksoi se me interes është faqja 7, te objektivat e Autoritetit për vitin 2011 dhe vitet e tjera, në mes të tjerash, duhet përmendur edhe nxjerrja e akteve normative brenda Autoritetit të Konkurrencës si dhe dhënia e opinioneve të ligjeve, të cilat e prekin konkurrencën. Si është dashur të punojë komisioni parlamentar në bashkëpunim me ju në këtë drejtim? Më intereson ta di, a keni pasur ju ndonjë rast deri më tani që ju të jepni opinionin e juaj rreth draftligjeve në lidhje me shkeljen e konkurrencës apo diçka tjetër? Te sfidat me të cilat ballafaqohet Autoriteti, çka kuptoni ju me përkrahje të pamjaftueshme institucionale? Keni cekur se keni memorandum bashkëpunim me ART-në dhe Bankën Qendrore, a do të thoni që ju duhet të vazhdoni më tutje të bëni memorandumin e institucioneve brendapërbrenda Kosovës dhe a mendoni se do të ndihmohen dhe do t'i ndihmojë edhe në vetëdijesimin te mëtutjeshëm? Një pyetje tjetër në faqen 16, lidhur me aktivitetin e seminareve dhe trajnimeve, a janë kriteret të cilat duhet t'i plotësojë Autoriteti i Konkurrencës që të jetë anëtar i barabartë, në mënyrë që të avancohet e mos të jetë vetëm anëtar vëzhgues i rrjetit të konkurrencës evropiane, a duhen hapa prej jush apo është gatishmëri e institucioneve të tjera, a duhet të bëni lobim, duke pasur parasysh që ju keni insistime ta përfaqësoni Kosovën në mënyrë të barabartë me të gjitha kompetencat e duhura?

Ahmet Krasniqi (AKK) – Iu përgjigj pyetjeve të parashtruara si në vijim: Se cili është fokusimi i AKK-së për krahasimin e kamatave dhe depozitave, këtë tha e ka bërë AKK-ja, por ndryshimi në mes të kamatave të kredisë dhe depozitave të kredisë është deri në 11%, ndërsa në gjitha vendet e rajonit është deri në 5.5%. Ne e kemi bërë këtë analizë, mirëpo ajo që për Autoritetin është pak më vështirë se kemi një disproporcion shumë të madh në treg, por është kusht me Ligj, nëse vendoset çmimi duhet ta ketë edhe pozitën dominuese, në këtë rast Banka Procredit ka 37% të tregut dominues. Me ligj është për të pasur deri në 40% fuqinë ekonomike në treg për të ditur se është në pozitën dominuese. Dhe atëherë të shikohet pse janë kamata më të larta apo më të ulëta dhe të nisë një hulumtim të thellë. Marrëveshjet janë shumë të vështira për t'i gjetur të shkruara. Mirëpo, Banka Raiffeisen dhe Procredit, të dyja së bashku e kanë deri në 68% pozitën

dominuese. Këtë çështje ne do ta grisim dhe në Komisionin Evropian të konkurrencës, sesi është e rregulluar në vendet e BE-së, se a kanë punë të përbashkët apo bashkëpunim për treg të përbashkët. Këtë çështje e kemi ngritur disa herë dhe në takimet tona të përbashkëta me homologët tanë, por kemi mbetur pa përgjigje. Në bazë të intervistave që kemi bërë në bankat komerciale të Kosovës, këta na thonë se ne jemi konkurrentë në treg, sepse kryejmë shërbimet të njëjta. Prandaj, ne si Autoritetit i Konkurrencës së Kosovës, jemi në fokusim për të gjetur një zgjedhje për këtë çështje. Për derivatet e naftës, ne kemi qenë në kontrollë nëpër pikat e shitjes. Por këta e arsyetojnë çmimin e shitjes në bazë të asaj sesi e kanë blerë në bursën ndërkombëtare të derivateve. Mirëpo ne ende nuk kemi mundur të gjejmë një mënyrë për t'i kontrolluar depot e mëdha në momentin që rritet çmimi sesa ka rezerva të derivateve dhe për të ditur se me çfarë çmimi e kanë marrë dhe me çfarë çmimi po e shesin. Për kompanitë e sigurimeve se a e kanë përmirësuar gjendjen, nuk konsiderojmë se jo. Kompanitë e sigurimeve e kanë bërë një kërkesë në Bankën Qendrore dhe deri më tani është bërë një prolongim i vendimit që e ka marrë Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës. Ne jemi në biseda me guvernatorin e BQK-së se përse nuk po zbatohet vendimi i AKK-së, dhe përgjigjja e tyre është se janë në negociata se Kosova do të hyjë në rrjetin e Byrosë së Kartonit të Gjellbër, prandaj ne ju kemi dhënë edhe një afat shtesë. Për licencat për media, tha se ne kemi pasur një shkresë nga televizionet që janë jashtë licencave nacionale, mirëpo nuk ka pasur bazë ligjore që të intervenojmë aty, sepse janë të tjera autoritete që i licencojnë kompanitë e mediave. Kërkesa e tyre ka qenë e paqartë dhe nuk kemi mundur t'ju ndihmojmë në këtë drejtim. Për kontrollet teknike, karburantet dhe arkat fiskale, ne iu kemi drejtuar ministrive përkatëse me rekomandime veç e veç për gjitha shqetësimet e qytetarëve, por ne nuk kemi bazë ligjore të dënojmë ministrinë për shkeljet e mundshme të konkurrencës. Sa u përket arkave fiskale, i kanë liberalizuar edhe dy operatorë të tjerë, mirëpo çmimi ka mbetur i njëjtë, porse a ka marrëveshje ne nuk mund ta dimë, sepse nuk kemi kapacitet teknik. Ne i kemi dënuar dhe njëherë, por tani me ligjin e ri, parashihet në deri në 10% të dëmit të bërë. Krahësimin me bankat e rajonit e kemi bërë dhe kamata është shumë e lartë tek ne sesa në rajon dhe po dëmtojnë shumë qytetarët, gati kanë kaluar në fajde se më nuk mund të quhen kamata. Për kërkesën nga kompanitë e sigurimeve, nëse nuk gabo, e ka bërë Shoqata e sigurimeve. Për Raportin e Progresit, ai tha se për kompanitë e sigurimeve që vijnë nga jashtë na kanë sugjeruar t'i zvogëlojmë depozitat, sepse janë shumë të larta, në 3 milionë dhe mund të mos vijnë në Kosovë, ndërsa se duhet të ndryshohet Ligji për konkurrencën, është gabim teknik, sepse fjala ka qenë për Ligjin për ndihmë shtetërore. Për çështjen se çka kuptoni me pavarësinë e Autoritetit, këtë na kanë sugjeruar në çdo takim që e kemi pasur me të huajt, në mënyrë që të ruhet pavarësia e Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës në marrjen e vendimeve, pra që të mos ndikohet drejtpërdrejt nga politika. Për memorandumet e bashkëpunimit tha se ne kemi memorandume bashkëpunimi me disa agjenci vendore dhe ndërkombëtare me bazë ligjore.

Hashim Deshishku – Për depozitat e kredive dhe kamatave, a keni bërë krahasime me vendet e rajonit, a jeni të obliguar që t'i auditoni pasqyrat e shpenzimeve dhe a janë të obliguara edhe kompanitë e sigurimeve të paguajnë TVSH-në?

Gani Asllani (anëtar i Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës –AKK) Iu përgjigj pyetjeve që kishin të bënin me raportin financiar, edhe pse kjo pjesë është nën përgjegjësinë e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe atje do të raportojmë. Për analizën dhe hulumtimet e bankave komerciale, ai tha se është hartuar një raport me analiza nga monitorimi për 6 muaj i bankave komerciale dhe këtë mund t'ua sjellim, por është edhe në ueb faqen e autoritetit.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2011.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2011.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

3. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit